

SHKËLZEN RAÇA

ABEDIN DINO NË LIDHJEN SHQIPTARE TË PRIZRENIT*

Vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në historinë e pasardhësve të iliro-arbrit, padyshim që përbëjnë pikën kulmore të procesit drejt konstituimit të shqiptarëve si komb më vete. Ishte koha, kur në dëmin e tyre, nisi tregtia me territore, që u ligjërue hapur në Kongresin e Berlinit.

Në këtë situatë ndërkombëtare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit shtriu në gjerësi e thellësi veprimet e saj për t'i dalë zot mbrojtjes së tokave nga copëtimi dhe sigurimit të autonomisë. Peticionet, mesazhet e protestat e shumta, janë vetëm disa nga nismat, të cilat dëshmojnë shkallën e lartë organizative drejt sensibilizimit të opinionit publik e politik ndërkombëtar.

Memorandumi i 13 qershorit dërguar nga Shkodra për kryeministrin britanik, lordit Bikonfild dhe telegrami i ideologëve të Lidhjes adresuar kontit Andrashi një javë më vonë, prezantojnë konsiderata të veçanta në planin diplomatik, si dhe gatishmërinë maksimale të Lidhjes për të ruajtur territoret shqiptare. Ajo, tashmë, me pak diversitete del si një dhe e tërë si në Veri, ashtu edhe në Jug.

Jemi në motin e mobilizimit të madh në Vilajetin e Shkodrës. Vullnetarët e mbledhur aty, shfaqën ndjenjën e thellë për t'iu kundërvënë çdo përparësie të Malit të Zi. Në të tillë organizim qëndronte edhe Vilajeti i Kosovës. Kthesa dramatike në marrëdhëniet Perandori Osmane-Lidhje Shqiptare e Prizrenit-Greqi do të pasojnë edhe në Jug, por aty nëpërmjet një lufte të njëmendët diplomatike.

Atje poshtë Shkumbinit, në pjesën më të madhe të territorit të Vilajetit të Janinës gravitonte popullata vitale shqiptare e administruar nga Porta, në kuadër të së cilës gjendeshin sanxhaqet e Janinës, të Prevezës, të Gjirokastrës e të Beratit me kazatë e tyre¹. Sikurse në Veri edhe aty ishin formuar komitetet e

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Kombëtare “Shqiptarët përballë sfidave të Bashkimit dhe të Lirisë”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 13 qershor 2008.

¹ Pas vitit 1867, Epiri si shprehje gjeografike, territoriale dhe politike, përfshinte thujtë tërë Tesalinë dhe pjesën më të madhe të Shqipërisë së Jugut, me Janinën, si qendër vilajeti. Më gjerësisht: *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv* (më tej: *HHSt.A.PA.*), “Konsullata e Janinës” Yanya vilayetin Salnamesi 1294-1877.

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që kishin shtrirje të gjerë veprimi deri në Konispol, pa përjashtuar dhe krejt Çamërinë.

Para konditave e rrethanave të tilla, viti kalendarik 1879 përshkohet nga ngritje tensionesh. Motivi i tyre ishin rekomandimet e Protokollit 13 të Kongresit të Berlinit, për një rishqyrtim të vijës kufitare osmano-greke. Në thelb, artikulli XXIV paralajmëronte se përcaktimi i kufirit greko-osman ishte në funksion të amputimeve serioze territoriale për viset e banuara me shqiptarë². Në të parashihej gjithashtu garancia e ndërhyrjes së Fuqive të Mëdha, nëse Porta dhe Greqia nuk binin dakord për një vijë të re kufitare³.

Kundërthëniet politike shqiptaro-greke u bënë të fuqishme më 29 qershor të vitit 1878, kur çështja greke doli përpara Kongresit të Berlinit me iniciativën e ministrit të jashtëm grek, Delijani, me deponimin e kërkesës për aneksimin e Kretës, të Epirit dhe të Thesalisë⁴. Diskutimet vijuan në seancën e tretë të sofrës së bisedimeve në kryeqytetin e Gjermanisë së bashkuar, rreth përcaktimit të kufirit greko-osman. Gjithçkaje nisi t'i vihej pika në seancën e trembëdhjetë. Në të vërtetë, linja e propozuar kufitare sipas shijes franceze-italiane, Salamvria (Peneusi i vjetër-lumi Kalamas), nuk ishte asgjë tjetër, veçse një goditje vdekjeprurëse për shqiptarët, sepse ajo përfshinte vise, që ata i konsideronin të tyre⁵.

Duke qenë se nëpër forumet dhe seancat e Berlinit, bisedimet diplomatike shkonin në favor të kërkesave greke, të tëra viset e banuara me shqiptarë u përfshinë nga një valë e madhe e revoltës. Shumicës shqiptare në Vilajetin e Janinës i kanosej rreziku i copëtimit serioze territoriale, arsye kjo, që motivoi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit të zhvillonte një aktivitet të gjerë diplomatik si me faktorin politik italo-austrohungarez, ashtu dhe me Portën, kundër kërkesave maksimaliste të shtetit grek. Në këtë drejtim, Lidhja kishte formuar komitetet e veta jo vetëm në Janinë, por edhe në Gjirokastrë, në Berat, në Vlorë, në Delvinë, në Përmet, në Filat, në Margëllëç, në Pargë, në Prevezë, në Tepelenë, në Artë e gjetiu. Ajo vepronte dukshëm në suazat e aksioneve politike me karakter ndërkombëtar.

Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Jugun nisi menjëherë mobilizimin ushtarak e politik. Në prag të Konferencës së Prevezës, shqiptarët shfaqën gatishmërinë të vërshonin drejt qytezës bregdetare, pavarësisht

² "Les protocoles du Congres du Berlin avec le Traite preliminaire de San Stefano du 19 fevrier (mars) et le Traite de Berlin du julliet 1878" (Extraite du journal du St. Peteburg), St. Peterburg: 1878, f.67-68.

³ Edouard Driault - Michel Lheritier, *Histoire diplomatique de la Grece de 1821 a nos jours*, vol. IV, Paris: "Les Presses Universitaires de France", 1925, f.492-493.

⁴ Stavro Skëndi, *The Albanian National awakening (1676-1912)*, Princeton: 1967, f.52.

⁵ "Les protocoles du Congres du Berlin ...", f. 67-68.

përkatësisë së tyre sociale e posteve që mbanin në administratën lokale të Vilajetit të Janinës. Ky ishte një çast i favorshëm pasi Porta kishte paralajmëruar nga mesi i dhjetorit të 1878-së për ardhjen e komisarit kryesor të saj, Gazi Muhtar Pashës dhe komisarit të “tretë”, Abedin Dinos. Së bashku me ta, do të vinte edhe adjutanti i sulltanit⁶.

Në vilajetin e Janinës dallohej dukshëm prania e komiteteve të Lidhjes. Aty kishte figura të spikatura, njëra më e zonja se tjetra. Megjithatë dy ishin kryesoret. Njëra ndër to ishte ajo e Abdyl Frashërit, diplomat e kundërshtar intransigent i afarizmit me njerëz e vende. Një figurë tjetër ishte edhe ajo e Abedin Dinos, i njohur herë -herë si Abedin Pashë Dino Preveza. Figura e tij deri vonë ndër ne dhe më gjerë është portretizuar me ngjyra të errëta. Shumica e autorëve e konsideronin atë si një person të Portës, të dhënë pas karrierës dhe pas ruajtjes së pronave që zotëronte në Prevezë e Paramithi. Shpalosja e dokumentacionit historik mbi Abedin Dinon, të çon në një drejtim tjetër. Roli i tij në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe në çastet më kritike të ruajtjes së indit etnik poshtë Konispolit, konfirmon të kundërtën.

Abedin Dino ishte një shqiptar nga Preveza, pronar i pasur tokash. Ai ishte njëkohësisht edhe anëtar i Komitetit Ndërkrahinor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Vilajetin e Janinës. Nuk ka dyshim se Abedin Dino pati poste drejtuese administrative në Perandorinë Osmane. Ishte kajmekam i qytetit ku u lind; mytesarrif i Tekirdagut dhe Varnës; komisar i Bursës në Gallata të Stambollit. Në fundin e vitit 1878 emërohet Komisar i Komisionit të Portës, që duhej të negocionte me palën greke rreth koncesionit tejet të dëmshëm territorial ndaj shqiptarëve në favor të Greqisë. Këtu nisi karriera e mirëfilltë politike e Abedin Dinos, në funksion të veprimeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Ka të ngjarë që Ministri i ardhshëm i Punëve të Jashtme të Perandorisë të kishte qenë i përfshirë që para 10 qershorit të vitit 1878 në aktivitetet me karakter thellësisht kombëtar shqiptar. Në këtë drejtim të çon gazeta greke “Stoa”, e cila vetëm një muaj para themelimit të Lidhjes në Prizren, apelonte: “Çështja shqiptare katandisi gurrë skandalesh, ndërsa një varg tezash e memorandumesh mbushën shtyllat e kumtarëve të përditshëm osmanë, ku më së tepërmi atakohej “Neollogos”. Duket se të gjitha këto reflektohen nga veprimet e Komitetit Shqiptar, i organizuar dhe i udhëhequr nga Pashko Vasa, një mirditor shqiptar, i krishterë, katolik dhe tejet i fanatizuar kombëtarisht. Mbledhjet zakonisht mbahen në shtëpinë e tij, ndërsa në ndihmë atij i dalin, Abedin Dino, përfaqësues i Portës në bursën financiare, pastaj Sami Frashëri, redaktor i organit më të madh këtu në Stamboll, “Terxhumanî Shark”, si dhe disa personalitete të tjera”⁷.

⁶ *HHSt.A.PA.* Informacioni No. 10, Raport i Oculit-Andrashit, Janinë, 8.02.1879.

⁷ *Στοά*, No.179, Έν Αθήναις, 28.06.1878.

Abedin Dino do t'i konsideronte që në fillim krim politik, ndëshkim me vdekje ndaj një populli të tërë, traktativat e Berlinit. Në këtë kontekst, ai ishte pranë Abdyl Frashërit, Mustafë Pashë Përmetit, vëllait të tij, Vesel Dinos, si dhe të delegatëve të Lidhjes nga Margëllëçi, Paramithia, Filati, Delvina, Tepelena e komitetet e tjera. Më 11 janar 1879 nga Preveza, ata i dërguan një Memorandum, Fuqive të Mëdha. Aty paralajmëronin konflikt të paparë, në rast copëtimi të viseve të Vilajetit të Janinës, të banuara me popullatë shumicë shqiptare⁸.

Pano Kollokotroni, major i artilerisë greke dhe anëtar i komisionit grek dëshmonte se: “Sabri Beu më porositi se, veprimet aktive të Abedin Dinos këtu në Prevezë kanë një avantazh të dukshëm dhe atij as që i shkon mendja të tërhiqet nga qëndrimet e veta”⁹. Sidoqoftë, një pohim tjetër nga po nga e njëjta bazë burimore, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Athinë, më 25 janar, vinte në dukje se: “Prania e Abedin Dinos inkurajon shqiptarët dhe Lidhjen e tyre, duke ngritur, sipas mendimit tim frymën e rezistencës”¹⁰. P. Kollokotroni më 17 shkurt nuk stepej të shkruante se: “Muhtar Pasha më priti me mjaft bujari para dy ditësh dhe nga ai takim fitova përshtypjen se nuk i merr shumë parasysh mendimet e Abedin Dinos”¹¹. Megjithëse të dhënat relevante burimore janë të pakta, në kuadrin e ndonjë njësie të vogël bibliografike, ndikimi i Abedin Dinos reflekton relevancë politike edhe në fundin e shkurtit të vitit 1879.

Në vijim, shqiptarët dhe Lidhja e Prizrenit për Jugun kundërshtuan Protokollin e 13 të Kongresit të Berlinit. Nga Preveza, ata dërguan memorandumun e njohur të 28 shkurtit, ku ndërmjet tjerash vinin në dukje se: “Ne shqiptarët jemi krejt të vendosur të flijohemi në altarin e atdheut dhe Greqisë mos t'i lëmë, veçse një fushë të madhe me kufoma, ku do të derdhet

⁸ Thelbi i Memorandumit të përpiluar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit për Jugun ishte i karakterit informativ, drejtuar Fuqive të Mëdha mbi çështjen shqiptare, ndërsa në të figuronin nënshkrimet e A. Frashërit, Mustafë Pashë Përmetit, Sabri Beut, Vesel Dinos etj. Më gjerësisht për këtë: *HHSSt.A.PA.*, XVII/37, “Konsullata e Janinës”. Raport i konsullit Gsiller dërguar nga Korfuzi, 20.01.1879, Blue book, Greece No.2 (1879), Doc.No.126, Telegram i delegatëve shqiptarë-Lajardit, Prevezë, 31.01.1879, f.86-87; Ligor Mile, *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I* (dokumente arkivash franceze), Tiranë: 1978, f.232-233; *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare* (përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha), Tiranë: 1978, f.37-38.

⁹ *Ιστορικό Αρχείο Μουσείου Μπενάκη* (më tej: *IAMB*), Fondi i Pano Kollokotronit. Raport dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Athinë, Informacioni No.15, Prevezë, 29.01.1879, 4, 213.

¹⁰ *Po aty*. Informacioni No.11, Prevezë, 25. 01. 1879.

¹¹ *Po aty*. Raport i Kollokotronit dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Athinë, Prevezë, 17.02.1879.

gjaku i bijve tanë¹². Supozohet se Abedin Dino ishte një ndër autorët e frymëzuesit e memorandumit të mësipërm, i cili kundërshtonte aneksimin e Epirit nga Greqia.¹³

Nëse do ta marrim si bazë mbështetjeje raportin e Kollokotronit, është për t'u dyshuar që Abedin Dino të kishte qenë person lojal ndaj Portës dhe oportunist përballë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, qoftë në Jug, qoftë në Veri, tutje Bjeshkëve të Nemuna ose në Vilajetin e Manastirit. Gazeta e liberalëve italianë "Bersaliere", e cila përcjell lëvizjet e Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vrionit në Itali, shkruante se këta përfaqësues të shqiptarëve vijnë për ta bindur Romën për t'iu kundërvënë pretendimeve të Greqisë për Epirin. Më 6 prill 1879, lajmëtari i përditshëm grek "Palingenesia", duke riprodhuar tekstin e komentuar në 5 prill të vitit 1879 në "Bersaliere", vinte në spikamë se: "delegacioni nxitet prej Abedin Dinos nga Preveza, një kryetar i Odës Tregtare të Stambollit. S'ka pikë dyshimi se kjo është e evidente"¹⁴.

Me gjithë dështimin e aksionit diplomatik të A. Frashërit e M. A Vrionit ndër kancelaritë e Fuqive të Mëdha, dy çaste me rëndësi ia vlejné të përmenden: 1) Qëndrimet e dy diplomatëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit bëjnë të ditur se ishin shqiptarët e jo Porta, ata që i rezistuan me ngulm vendimeve të Protokollit të 13 të Berlinit, duke kërcënuar madje me një kryengritje të përgjithshme. 2) Si pasojë e vizitës së tyre në Romë, Vjenë, Berlin, Paris, Londër dhe së fundi në Stamboll, disa kumtarë të Evropës po paralajmëronin një ritrajtim të linjës kufitare greko-osmane. Anglia, Gjermania dhe Rusia duket se kishin filluar ta merrnin në konsideratë qëndrimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për t'i dhënë Greqisë një kompensim territorial në Thesali.

Roli i Abedin Dinos ishte evident edhe në protestën që shqiptarët e Stambollit i drejtuan në prag të Konferencës së Berlinit, kryetarit të tubimit të paralajmëruar në kryeqendrën e Gjermanisë. Kjo protestë arriti të materializohet vetëm pas thirrjes së Abedin Dinos drejtuar disa personaliteteve shqiptare në kryeqendrën e Portës, për organizimin e një mbledhjeje të posaçme. Në të theksohej edhe një herë se, shqiptarët ishin krejtësisht të vendosur dhe me tërë qenien ta ruanin integritetin territorial¹⁵.

Shikuar nga një këndvështrim ndoshta më realist për kohën, duke mbajtur parasysh edhe interesat jetike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abedin Dino nuk pati zgjidhje tjetër veprimi, përveç se të vepronte i kamufluar. Si një zyrtar

¹² *Akte të Rilindjes Kombëtare...*, f.76-78.

¹³ Stamatios Th. Laskaris, *La politique exterieure de la Grece, avant et après le Congres de Berlin (1875-1881)*, Paris: 1924, f.156.

¹⁴ *Παλιγγενεσία*, No.4395, Αθήνα, 5.04.1879.

¹⁵ *HHSt.A.PA.*, Konsullata e Janinës, XVI/73. Telegram i Oculit-Haymerles, Janinë, 18.06.1880; *Akte të Rilindjes Kombëtare ...*, f.103.

i lartë i Portës, ai detyrohej herë-herë t'i bënte lajka sulltanit ose në instancën e fundit, ashtu i fshehur pas Lidhjes, të bënte me dije se vetëm Porta ishte e denjë t'i mbronte interesat ekzistenciale të shqiptarëve. Me gjasë, i nxitur nga motivet thjesht diplomatike, në funksion të ruajtjes së substancës kombëtare, ai pranoi ofertën për të qenë pjesë e qeverisë së re osmane, me kryeministër Kadri Pashën.

Duke marrë parasysh rolin e Abedin Dinos në organizimin e demonstratave në Konferencën e Prevezës, ishte e pritshme që në cilësinë e Ministrit të Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, ai të mos pajtohej me koncesionet territoriale në favor të Greqisë e të Malit të Zi. Këtu kishte vend edhe interesi i themelueses të demokracisë parlamentare, Anglisë. Vetë Abedin Dino mendonte se emërimi i tij i detyrohej dëshirës së sulltanit, për t'i bërë për vete britanikët¹⁶. Mund të supozohet se me mbështetjen e Anglisë "osmani i natyralizuar", në prag të Konferencës së Berlinit synonte të krijonte disa favore për shqiptarët dhe Lidhjen e tyre të Prizrenit, në Vilajetin e Janinës. Bëhet fjalë ekskluzivisht rreth vijës kufitare greko-osmane, për të cilën Abedin Dino do t'i deklaronte ambasadorit britanik Goshen në Stamboll se prekja e interesave të shqiptarëve në kryeqendrën e Gjermanisë, do të thoshte edhe shmangie e Portës.

Sidoqoftë, në vitet e para të ushtrimit të detyrës së tij, shtypi evropian e identifikoi pa dilemë Abedin Dinon si figurë që preferoi rezistencën pasive të shqiptarëve e Lidhjes së tyre. Gazeta franceze "Debats" përkujtonte se "Abedin Pashë Dino nuk iu shmang asnjëherë idesë kundër koncesioneve territoriale në favor të Greqisë, ndërsa prej shumë zyrtarëve të huaj, do të denoncohet për kultivimin e lidhjeve të ngushta më udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare. Po i njëjti kumtar shtonte se "Abedin Dino e thotë qartë dhe pa hezitim se është për Shqipërinë, por jo për një shkëputje të plotë nga Perandoria Osmane, sepse ajo do të mbetej sikurse një anije pa timonier, ashtu e vetmuar në mes të oqeanit".

Qëndrimi bindës i Abedin Dinos ndaj Portës e Fuqive të Mëdha, në lidhje me çështjen shqiptare, vihet në dyshim kryesisht pas Rezolutës së Konferencës së Berlinit të 1 korrikut 1880, që i atribuoi favore territoriale, Cetinës dhe Athinës. Gazeta e famshme e kohës, që dilte në Athinë "I foni tis Alvanias", vetëm 11 ditë më vonë, do të shkruante, se "Abedin Dino, që ka lidhje të ngushta jo vetëm me toskët, por edhe me gegët, ka filluar të shfaqë dallime të skajshme me Sava Pashën e Kadri Pashën"¹⁷. Duket haptazi se Ministri i Punëve të Jashtme po i bënte ballë presionit të Portës dhe Fuqive të Mëdha. Një qëndrim i tillë me gjasë reflektohet edhe në Çamëri. Në këtë

¹⁶ William Norton Medlicott, *The Congress of Berlin and after: A diplomatic History of Near Eastern Settlement (1878-1880)*, Second Edition, London: "Frank Cass & Co.", 1963, f.94.

¹⁷ *Η Φωνή της Αλβανίας, έν Αθήνας*, No.34, 12.06.1880.

kontekst, burimet diplomatike evidenconin se në tensionin e krijuar rreth përkatësisë greke a osmane të Epirit, një ndikim të fuqishëm pati nota zyrtare e 26 korrikut të vitit 1880. Duket e besueshme se në këtë dokument kishte gisht edhe Abedin Dino, bashkë me figurat e dalluara të Lidhjes së Prizrenit për Jugun. Në këtë mënyrë nota merrte vulën e një vendimi gjithë shqiptar¹⁸.

Shqiptarët e Margëllëçit, së bashku me ata të Filatit e Paramithisë po shqyrtonin seriozisht rezistencën kundër pretendimeve territoriale greke. Gazeta e Anastas Kulluriotit, “Zëri i Shqipërisë” shkruante se, rezistenca bëhej në emër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndërsa vetë Abedin Dino, një figurë me plot ndikim në tërë Vilajetin e Janinës, mendoj që pati rol të madh në organizimin e saj.

Së fundi, pa pretenduar të ndriçojmë tërësisht figurën e kontestuar të Abedin Dinos, e konsiderojmë të domosdoshme rishqyrtimin e rivlerësimin e mëtejshëm të aktivitetit të tij. Abedin Dino me potencën mendore e politike, gjithnjë i kamufluar, afirmoi vlerat politike të shqiptarëve e të Lëvizjes së tyre Kombëtare edhe në nivel ndërkombëtar. Si një person me ndikim të fuqishëm në veprimet e Lidhjes, shpeshherë në qarqet e ndryshme diplomatike, ai u artikulua si zyrtari që pengoi procesin e zgjidhjes së përplasjes territoriale greko-osmane, që do të thotë dhuratën që Fuqitë e Mëdha po i ofronin Greqisë, me viset përtej Konsipolit, aso kohe të banuara me shqiptarë. Pikërisht këtu qëndroi edhe motivi qendror i shkarkimit të tij nga posti i Ministrit të Punëve të Jashtme. Porta e bëri këtë, sepse konfirmoi se Abedin Dino mbeti një përkrahës i ruajtjes së kufijve të Shqipërisë, në jugun ekstrem të tyre. Sakaq, koncepti i tij i matur rreth çështjes të autonomisë së Shqipërisë, kujtojmë se ishte më tepër qëndrim i një realiteti të dhunshëm politik, se sa i ruajtjes së pronave ose i pretendimeve personale, në lartësitë e skenës politike osmane.

¹⁸ *HHS*.A.PA., XVII/3, “Konsullata e Janinës”. Raport i Bermezoviqit-Haymerles, Janinë, 13.08.1880; Blue book 1 (1881), Qarkorja No.110, Trikupis-Kondostavillos, Athinë, 28,06/10.07.1880.

